AKT- THEMELIMI

Sot më datë 7.08.1996, unë Fadil Bajram Kora, i datëlindjes 22.shkurt.1958, lindur në katundin Dardhë Berat, banues në lagjen "4 shtatori " Urë - vajgurore Berat, pall.nr.32, me dëshirë time, meqënëse plotësoj kushtet e parashikuara nga ligji për shoqëritë tregtare, morra vendim për të krijuar si " Ortak i Vetëm" shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar " Albano" Shpk.

Qendra e shoqërisë "Albano" Shpk, është në Urë vajgurore Berat lagje " 4 shtatori".

Kapitali themeltar fillestar është në vlerën 100.000 lekë.

Kohë zgjatje e veprimtarisë saj është mbi 10 vjet, ajo mund të shpërbëhet np çdo kohë.

Shoqëria private " Albano" Shpk, është person juridik dhe akti viteti saj zhvillohet në përputhje me këtë akt themelimi dhe statutin që i bashkëngjitet.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:Në fushën e ndërtimit, kat-1 punime dheu,murature, betoni, b/arme të zakonshme, punime shembjesh, Kat-2 ndërtime civile, industriale, turistike, bujqsore e tj dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to,Kat-3 punime restaurimi

Në fushën eshërbimeve publike, shërbimeve funerare, pastrimgjelbërime,kanalizime të ujrave të zeza dhe mirëmbajtje të rrugëve dhe trotuarve. Në fushën e tregtisë me shumicë e pakicë, eksport-import të artikujve të ndryshëm industriale, ushqimore,produkteve bujqësore e blegtorale,paisje e makineri të llojeve të ndryshme, paisje elektroshtepijake, hydrosanitare, pesticide, plehra kimike,materiale e lëndë të ndryshme ndërtimi,grumbullim e tregtim të bimëve medicinale e prodhime të ndryshme të pyllit, tregtim pije alkoolike, freskuese e birra.

Këtë aktivitet ajo do ta zhvilloj si " Ortak i vetëm" në shoqrinë " Albano" Shpk.

Akti themelimit mbështetet në kërkesat e ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare e pasi të regjistrohem në organet kompetente, Gjykatë të rrethit Tiranë e zyrën përkatëse të tatimeve,do do filloj zhvillimin e aktivitetit sipas objektit që përmban statuti e vendimi gjykatës për regjistrimin si person juridik, të shoqërisë "Albano" Shpk. Respektimi i normeve të statutit të hartuar për këtë qëllim e norameve ligjore në fuqi e ato që do vijojnë do përbëjnë synimin tim gjatë zhvillimit të veprimtarisë private në shoqërinë "Albano"Shpk.

Shoqëria " Albano" Shpk,drejtohet nga administratori i saj që është " Ortaku i vetëm" Fadil Kora.

Pasi lexohet akti themelimit nënshkruhet rregullisht përpara Noterit Publik.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË " ALBANO" Shpk

/ Fadil Kora /

# S T A T U T

## I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE " ALBANO" Shpk

### E M Ë R T I M I

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private " A L B A N O" Shpk,eksport-import, me ortak të vetëm Fadil Bajram Kora,i datëlindjes 22.shkurt. 1958, banues në lagjen " 4 shtatori", pall.32 Urë-vajgurore Berat.

### VEND QENDRIMI

Neni 2

Vend qendrimi i shoqërisë " Albano " Shpk, është në lagjen "4 shtatori" Urë- vajgurore Berat.

Shoqëria,në zhvillimin e aktivitetit të saj,mund të hapë dhe vendqëndrime të tjera, operative, filiale, agjensi në gjithë territorin e vendit, si dhe jashtë Shqipërisë me miratimin e organeve kompetente.

### KOHË ZGJATJA

Neni 3

Kohë zgjatja e shoqërisë " Albano" Shpk, është mbi 10 vjet,ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Në fushën e ndërtimit, kat- 1 punime dheu,murature, betoni,b/arme e zakonshme,punime shembjesh.

Kat-2 ndërtime civile, industriale, turistike, bujqsore e tj: dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to.

Kat-3 punime restaurimi.

(Bazuar në Liçensën Nr.Z 0893 da të 02.06.1994 të Ministrisë së Ndërtimit,Strehimit dhe Rregullimit të Territorit).

Në fushën e shërbimeve publike, shërbimeve funerare,pastrim-gjelbërimë,kanalizime të ujrave të zeza dhe mirëmbajtje të rrugëve dhe troturave.

Në fushën e tregtisë me shumicë e pakicë, eksport- import të artikujve të ndryshëm industrial,ushqimor, produkteteve të ndryshme bujqësore e blegtorale,paisje e makineri të llojeve të ndryshme, paisje elektroshtepijake, hydrosanitare, pesticide, plehra kimike,materiale e lëndë të ndryshme ndërtimi, grumbullim e tregtim të bimëve të ndryshme medicinale e prodhime të ndryshme të pyllit, tregtim pije alkoolike, freskuese e birra.

Megjithë këtë,shoqëria ka të drejtë të shtojë objektin evep-

risë saj, me vendim të gjykatës së rrethit Tiranë.

## KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar është në vlerën prej 100.000 lekë i formuar tërësisht nga ortaku i v etëm Fadil Kore.

Neni 6

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet sipas vendimeve që do të marrë pronari i saj.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 7

Shoqëria " Albano" Shpk, deklarohet e krijuar, në zbatim të plotë t normave që përmban ky statut dhe ato të legjislacionit Shqiptar në fuqi, ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare " dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Ajo fiton zotësi për të vepruar, me regjistrimin e saj si perso juridik në Gjykatë të rrethit Tiranë, ndërsa aktivitetin privat me regj strimin në organet përkatëse financiare të rrethit, ku ajo ka qendrën e e saj.

Neni 8

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje " shoqëria Albano Shpk, eksport -import Berat".

Neni 9

Shoqëria merr përsipër të drejtat dhe detyrimet që rjedhin nga aktet e administrimit. Ajo përgjigjet për detyrimet kontraktore e jashtë-kontraktore brenda kapitalit të saj. Ortaku ivetëm i shoqërisë mbart rezi kun e veprimtarisë saj, në nivelin e shumës së mjeteve të investuara.

Neni 10

Shoqëria " Albano" Shpk, është pronë e Z. Fadil Kore, themelues i saj. Ai merr vendime në zbatim të ligjeve të fuqi dhe sipas këtij statu ti, të cila janë të detyrueshme për të gjithë të punësuarit në shoqëri.

Zoti Fadil Kore, si pronar i shoqërisë është njëkohësisht dhe administrator i saj.

Neni 11

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të emrojë ekonomisht e Avokat , si dhe persona të tretë me prokurë për ndjekjen e aktivitetit të shoqërisë.

Neni 12

Administrat ri i shoqërisë në përputhje me ligjin kryen veprim et e nevojëshme për realizimin e detyrave të saj. Ai ka të drejtë, midis të tjera të blejë e të këmbejë pasuri, të lidhë marrdhënie me shoqëritë e tjera vendëse dhe të huaja, brenda dhe jashtë vendit, të kryej çdo

lloj veprimi pranë gjithë zyrave private apo shtetërore, që kanë të bëjnë me garancitë, hipotekat, të kryej veprime depozitimi pranë instituteve bankare e financiare, kreditime e pagese, arkëtime e tj.

Neni 13

Përfaqësimi i shoqërisë " Albano " Shpk, i përket vetëm administratorit dhe përfaqsuesit të caktuar prej tij. Ata kanë të drejtën e përfaqsimit të saj në organet gjyqsore e administrative, të caktojnë persona të tjerë me prokurë të posaçme, si dhe Avokat për çështje në Gjykim.

MARDHËNIET E PUNËS

Neni 14

Mardhëniet e punës në shoqëri rregullohen sipas kontratës së punës. Për çështje që në këtë kontratë nuk gjejnë zgjidhje dhe raste konfliktesh, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Neni 15

Administratori i shoqërisë emron përfaqsuesin, të cilit në aktin e emrimit i përcakton detyrën dhe pagën. Po kështu, edhe për punëtorët, shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat e punësimit dhe sigurimit në Republikën e Shqipërisë.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 16

Veprimet ekonomiko - financiare të shoqërisë mbyllen në 31.dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe administratori nxjerr bilancin kontabël të shoqërisë dhe llogarinë fitim humbje, bazuar në rregullat e mbajtjes së kontabilitetit për subjektet private, të përcaktuara nga organet kompetente të sistemit fiskal.

Administratori vendos për krijimin e fondeve të nevojshme për zhvillimin dhe garancinë e veprimtarisë së shoqërisë, si fondin e akumulimit, fondin rezervë e tj.

Neni 17

Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve ligjore të përmbushura në nenin 18 dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale nga fitimi, i mbeten në përdorim pronarit të shoqërisë.

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Neni 18

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çdo shkak, si humbje kapitalit, pamundësi veprimtarie e tj. Në këtë rast prona

ai shoqërisë vendos për mënyrën e likujdimit dhe cakton një ose më shumë likujdatorë, të cilët kujdesohen që shoqëria të likujdojë më parë detyrimet që u ka personave të tretë fizik e juridik.

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 19

Për sa nuk shprehet në këtë statut i referohet plotësimeve nga Pronari i shoqërisë, si dhe ligjeve përkatëse në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 " Për Shoqëritë tregtare "

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË"ALBANO"Shpk

FADIL KORA

REPUBLIKA E SHQIPRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 2129 Rep.
Nr. 447 Kol.

V E R T E T I M

Sot më datë 8.08.1996, Në zyrë të Noterisë Tiranë, përpara meje Noterit Publik, mu paraqit personalisht Fadil Kora, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi tij personal,madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili deklaroi se statutin si më sipër e bën me vullnetin e tij të plotë e të lirë dhe nënshkruan para meje Noterit dhe unë Noteri e vertetoj atë.

N O T E R E

PULLE TAKSE 15 LEKE REShQIPERISE
PULLE TAKSE 15 LEKE REShQIPERISE
PULLE TAKSE 20 LEKE REShQIPERISE

NOTERE
LINDITA KOKONA
TIRANË ALBANIA